



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Sahit Beqiri - Ekspert Shqyrtues 	Data e autorizimit të ekspertit: 12.12.2019	Data e dorëzimit të raportit: 16.12.2019	Nr. i lëndës: 897/19
--------------------------------------	---	--	----------------------

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.12.2019, OE: “AAB Construction” Sh.p.k. - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr. 897/19, kundër B58 njoftimit mbi vendimin AK (njoftimit për dhënie të kontrates), ku është rekomanduar për kontratë OE: “Visar Kuçi” B.I. – Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ta pastrojmë Kosovën - Komuna e Suharekës”, me nr. të prokurimit: 624-19-8500-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Komuna e Suharekës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë e hapur, lloji i kontratës: Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 €.

Shënim: Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit nuk është nxjerr ndonjë vendim nga OSHP-ja.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 7

Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.
3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi të artikujve të tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.
4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.
5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë

ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkesë të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.

Neni 59

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

1. Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacionin detyrues lidhur me këtë çështje.

Neni 60

Kriteret për Dhënien e Kontratës

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Letrën standarde për tenderues eliminuar e kemi pranuar përmes platformës elektronike, me pas kemi parashtruar kërkesë për qasje në dokumentacion.

Gjate qasjes në dokumentacion në kemi vërtetuar se një numër të madhe të shkeljeve që janë bërë në momentin e shpalljes fitues të kompanisë Visar Kuqi B.I.

OE Visar Kuqi B.I. është dashtë të shpallet nga ana e AK si OE i papërgjegjshëm, nga që nuk ka ofruar dëshmi që posedon Licencën për eksport, import, prodhimin e drunjtëve dekorativ, si qeshte kërkuar në FDT konkretisht Kërkesa nr. 6 tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale ku kërkohej kopja e licencës për prodhimin e drunjtëve dekorativ e lëshuar nga MBPZHR, duke parë që OE i propozuar për kontratë nuk e ka përmbushur këtë kriter tepër të rëndësishëm pasi që si projekt si pike primare e ka mbjelljen e drunjtëve dekorativ, konstatojmë që AK ka bërë shkelje të LPP-së, në momentin që ka shpallur fitues një OE të papërgjegjshëm.

AK po ashtu në fillim të procedurës së prokurimit, AK ka bërë shkelje të LPP-së, ku në kërkesat e FDT-së ka futur një kriter diskriminues ku ka kërkuar në kërkesën nr. 4 – Operatori duhet të ketë Certifikatë nga prodhuesi për artikullin kryesor pllaka Terreaco e mermerit (pozicioni 5.3) me të cilën planifikohet të rregullohen parqet, ku dihet qartë që ekziston vetëm një kompani në Kosovë që prodhon këto pllaka dhe është i vetmi i autorizuar për shitje, andaj është e pamundur që me të bëhet marrëveshje e furnizimit për të njëjtën procedurë të prokurimit pasi që ai vetëm me një kompani i bënë marrëveshjet. KRPP-ja e ka

SeB

identifikuar me shumë se një here ketëkërkesë si diskriminuese për projekte po thuajse të ngjashme ku edhe lehtësisht mund të vërtetohet, andaj kërkojmë nga Organi shqyrtues i prokurimit ta marrë për bazë këtë. Dhe të vërtetojë konformë LPP-së, pasi që AK – KK Suharekë, ka bërë shkelje të LPP-së.

Duke u bazuar në gjetjet e lartë shënuara konstatohet se AK Suharekë, në momentin e shpalljes fitues të kompanisë Visar Kuqi B.I. ka bërë shkelje të LPP-së nga që ky operator ekonomik nuk i ka përmbushur kriteret e FDT-se në momentin e dorëzimit të tenderit, dhe është detyrues të eliminohet si OE i papërgjegjshëm.

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, që ta anulohet vendimi për kontratë duke u bazuar tek pika e parë, po ashtu duke u bazuar tek pika e dytë, ta anulohet procedurën e prokurimit nga që AK ka bërë shkelje të LPP-së, duke kërkuar kriteret diskriminuese.

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, nuk janë identike me kërkesën për rishqyrtim pranë AK, sepse OE në kërkesën për rishqyrtim pranë AK nuk dhënë fare deklaratë detaje për shkeljet kurse të dispozitave ligjore ka përmend vetëm kërkesën nr. 6, duke ngritur si pretendim se i mungon licenca për prodhimin drunjëve Dekorativ të lëshuar nga MBPZHR

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëmkërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore).

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kapaciteti teknik dhe profesional: *Dëshmia e kërkuar dokumentare*

Kërkesat:

Kërkesa2 -Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Staf i kualifikuar në fushën perkatese, se paku një Inxhinier i diplomuar në ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose master i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, që ka tri vite përvojë pune pas diplomimit dhe një agronom i diplomuar, me së paku tri vite përvojë pune.

Kërkesa4 – Operatori duhet të ketë Çertifikatë nga prodhuesi për artikullin kryesor pllaka Terreaco e mermert (pozicionet 5.3) me të cilin planifikohet të rregullohen parqet.

Kërkesa 5 –Certifikata nga prodhuesi ose perfaqësuesi i Autorizuar, për lodrat e paraqitura si në skemat e përshkrimit teknik.

Kërkesa 6 Për drunjet që do të mbillen, OE duhet të ofrojë kopjen e certificate sfitosanitare e cila dëshmon se mallrat janë sipas standardeve të BE-së.

Evidencat:

Dëshmia2 - Kontrata e punës ose marrëveshja me inxhinierin, Diploma e NOTERIZUAR dhe një CV.

Dëshmia4. Certifikata e prodhuesit e noterizuar.

Dëshmia5. Certifikata nga prodhuesi ose perfaqësuesi i Autorizuar e noterizuar.

Dëshmia6 - Licence për eksport, import, prodhimin e drunjeve dekorative. Kopja e licences për prodhimin e drunjeve dekorative të lëshuar nga MBPZHR.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

(Të përshkruhet vetëmkërkesimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Komisioni pasi vlerësoi ofertat konkurruese i rekomandon ZP-së të shpallë fitues OE VISAR KUQI B.I NË VLERË PREJ: 99.547,00 €.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA E EKSPERTËVE SHQYRTUES

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

Duke marr per baze se OE ankues, nuk ka rrit te plotesoj, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 9.1 & 9.2, kërkesa/dëshmia nr. 4 te FDT-së, andaj nuk është pale me interes sipas nenit 4.1.26 të LPP-së.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësimtjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "AAB Construction" Shpk - Prishtinë

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka shkelur nenin 7, 59 dhe 60 të LPP-së.

Duke pas parasysh se OE ankues në pajtim me nenin 108/A të LPP-së, ka pasur mundësi dhe është dashur që paraprakisht të gjitha pretendimet e veta ti parashtron pran AK, e qe ne rastin konkret OE ankuese, këtë pretendim nuk e ka parashtruar fare pranë AK me kërkesën për rishqyrtim, eksperti shqyrtues bazuar ne nenin 109 të LPP-së si dhe paragrafit 9.2 të nenit 9 te dokumentit F03 Rregullat për parashtrim te ankesave-verzioni 2, ku thuhet: "Ankesa do te dorëzohet ne origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet te jene te njëjta me ato te paraqitura ne Autoritetin Kontraktues" si dhe neni 13 par. 9 i Rregullores së OSHP-së Nr. 01/2017, në të cilën thuhet: "Ankesat duhet të jenë të qarta, e shkurtër, dhe me pretendimet e supozuara që eventualisht janë shkelur nenet e caktuara të LPP-së nga ana e Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore parimisht duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në Autoritetin Kontraktues", andaj nga të cekurat si më lartë pretendimet në fjale nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues është dashtë te shpalle si OE – "Visari Kuqi" B.I. i papërgjegjshëm, nga qe nuk ka ofruar dëshmi qe posedon Licencën për eksport, import, prodhimin e drunjtëve dekorativ, si qeshte kërkuar ne FDT konkretisht Kërkesa nr. 6 tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale ku kërkohet kopja e licencës për prodhimin e drunjtëve dekorativ e lëshuar nga MBPZHR.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit (ne këtë aktivitet te prokurimit), duke u bazuar ne, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 9.1 & 9.2, kërkesa/dëshmia nr. 6 te FDT-së, po citoj: "Kërkesa 6 Për drunjtë qe do te mbillen, OE duhet te ofroje kopjen e certifikatës fitosanitare e cila dëshmon se mallrat janë sipas standardeve te BE-se. Dëshmia 6 - Licence për eksport, import, prodhimin e drunjeve dekorative. Kopja e licencës për prodhimin e drurëve dekorative e lëshuar nga MBPZHR", Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te

S.B

kontratës ne platformën elektronike, lidhur me piken nr. 6 te FDT-së, ka prezantuar marrëveshjen bashkëpunim për furnizim ne mes te OE: “Visar Kuqi” B.I. me Nr. Unik: 811039579, përfaqësuar nga Visar Kuqi dhe OE: N.T.P. “Las Pallmas” ne nr. Fiskal: 60045240, përfaqësuar nga Luan Buqaj, e cila hyn ne fuqi nga data 15.11.2019, duke i ‘ja bashkangjitur kësaj marrëveshje, këto dokumente, si ne vijim: Phytosanitary Certificate No. EC / NL/ Original PCNU 153989058 me date 24-May-2018. OE i rekomanduar për dhënie te kontratës me rastin e dorëzimit te tenderit përmes platformës elektronike e-prokurim, nuk ka prezantuar dëshmitë si: **Licence për eksport, import, prodhimin e drunjtëve dekorative.**, dhe AK përmes letrës standarde për sqarimin e tenderit te datës 21.11.2019 përmes platformës elektronike, ne pajtim **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 39 të RrUOPP-së.** ka kërkuar nga OE: “Visar Kuqi” B.I., qe te sjelle edhe licencën e MBPZHR-se si kërkesë/dëshmia nr. 6 te FDT-së, nga MBPZHR, operatori ekonomik ne fjale ka sjelle **licencën për importim te fidanëve për bime dekorative me nr. prot. 199** ne emër te OE: N.T.P “Las Pallmas” data e licencimit: 21.01.2019 dhe data e skadimit: 24.09.2020, lëshuar nga MBPZHR, duke e ngarkuar përmes platformës elektronike. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është **pjesërisht i qëndrueshëm.**

Gjithashtu, **eksperti shqyrtues sqaron** si ne vijim: Është kompetence dhe përgjegjësi e plote e autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit të vlerësimit/ri-vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve me kusht që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin të bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, duke marr parasysh Aneksin 1 në dosje të tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara qe te sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marr ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet ne **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikas, me transparent dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve dhe burimeve publike.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe rekomandon që të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- | | |
|---------------------------|--|
| - Autoritetit Kontraktues | - Komuna e Suharekës |
| - Panelit Shqyrtues | - OSHP |
| - OE ankues | - “AAB Construction” Sh.p.k. – Prishtinë |